



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ

<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>



KRYETARI I KOMUNËS
MUNICIPAL PRESIDENT
PREDSIEDNIK OPSTINE

Tel / Fax: 038/200-46002
Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.
E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

DATA/DATUM/DATE	19.02.2026
01 NR/BR.	44 / 26

PËR/ZA/TO	Kuvendin e Komunës.
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Komitetit për Politikë dhe Financa Kryesuesit të Kuvendit të Komunës Xhavit Zariqi
NGA/OD/FROM	Kryetar i Komunës z. Agim Aliu
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Propozim Vendim për miratimin e Rregullores për Ushtrimin e Veprimtarisë së Transportit Publik të Udhëtarëve me Taksi.

Në bazë të nenit 58 pika 1. h. të Ligjit, Nr. 03/L -040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 51 pika 2.9, të Statutit Komunës së Ferizajt 01 Nr. 50, i datës 28.06.2013 dhe nenit 6 të Ligjit për Transportin Rrugor Nr. 04/L-179 të datës 16.05.2013, Kryetari i Komunës bënë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Propozim - Vendim për miratimin e Rregullores për Ushtrimin e Veprimtarisë së Transportit Publik të Udhëtarëve me Taksi.

A r s y e t i m

Komuna e Ferizajt ka pasur të miratuar Rregulloren për Ushtrimin e Transportit Publik të Udhëtarëve në Territorin e Komunës së Ferizajt në vitin 2007, mirëpo për shkak të ndryshimit të Ligjit për Transportin Rrugor, Plotësim dhe Ndryshimet që janë bërë, dhe ndryshimeve të Udhëzimeve Administrative në këtë fushë, komunat e Republikës së Kosovës janë të obliguara të harmonizojnë këto dy dokumente me ndryshimet ligjore.

Me këtë Rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat administrative për organizimin e transportit publik të udhëtarëve me taksi brenda territorit të Komunës së Ferizajt.

Komuna e Ferizajt, përmes Zyrës së Informimit dhe Komunikimit me Publikun, ka përfunduar të gjitha procedurat edhe të konsultimit publik, andaj propozoj që ky dokument edhe të miratohet.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Ferizajt
Opstina Uroshevac -Municipality of Ferizaj



RREGULLORE PËR
USHËTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT
PUBLIK TË UDHËTARËVE ME TAKSI

FERIZAJ, 2025

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja c), dhe nenit 40, paragrafi 40.2, shkronja a) e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/04 qershor 2008), nenit 15, shkronja f) të Ligjit nr. 03/L-049, për financat e pushtetit lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 27/03, qershor 2008) dhe të nenit 10 paragrafi 2 pika 2.2. të Statutit të Komunës së Ferizajt 01.Nr.50 të datës 28.06.2013 dhe nenit 6 të Ligjit 04/L-179 për Transportin Rrugor Kuvendi i Komunës së Ferizajt, në mbledhjen e mbajtur më datë _____, e miratoi këtë

RREGULLORE PËR USHËTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE ME TAKSI

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen kriteret dhe procedurat administrative për organizimin e transportit publik të udhëtarëve me taksi (taxi) brenda territorit të Komunës së Ferizajt.

Neni 2

Rregullimin dhe organizimin e transportit të udhëtarëve me taksi në territorin e Komunës së Ferizajt e kryen Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Inspeksionit.

Neni 3

Të gjitha shprehjet apo përkufizimet në Ligjin Nr. 04/L-179 Për Transportin Rrugor e kanë kuptimin e njejtë edhe në këtë Rregullore.

Neni 4

Transporti Taksi është transporti publik i personave në transportin jo të rregullt rrugor (jashtë linjor) për të cilin çmimi për rrugën e kaluar është që më parë i njohur dhe përcaktohet në bazë të taksimetrit sipas çmimorës së shërbimeve të vërtetuar nga organi kompetent i Komunës së Ferizajt.

Neni 5

1. Transportuesi që kryen transport taksi të udhëtarëve është i obliguar që me kërkesën e udhëtarit t'i jep atij dëshminë për shërbimin e bërë, e cila dëshmi përmban: regjistrimin e automjetit, relacionin, kohën e transportit dhe çmimin për shërbimin e kryer.
2. Transportuesi taksi është i obliguar që udhëtarin ta transportojë në relacionin sa më të shkurtë të mundshëm.
3. Automjetet taksi nuk mund të pranohen nëse në automjet ka të vendosur mjete shtesë për bartje (rimorkio) si dhe në rastet ku ekziston mundësia të vendosen ulëse shtesë.

II. KUSHTET E PËRGJITHËSHME PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT PUBLIK TË UDHËTARËVE TAKSI

Neni 6

1. Transportin e udhëtarëve me taksi mund ta ushtrojnë personat fizik dhe juridik, të cilët janë të pajisur me licencë – leje për kryerjen e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve taksi të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligj dhe me këtë rregullore.
2. Numri i lejeve të transportit taksi duke u bazuar në numërin e banorëve në Komunën e Ferizajt nuk mund të jetë më shumë se 250 leje të transportit taksi individual dhe 7 lejeve të operatoreve taksi.
3. Numri i licencave – lejeve nga paragrafi 2 i këtij neni për ushtrimin e veprimtarisë taksi mund të ndryshohet me vendim të veçantë nga Kryetari i Komunës së Ferizajt, në bazë të rekomandimeve nga ekspertët e kësaj fushe.

Licencë – Leje për taksi individual (auto-taksi).

Neni 7

1. Përveç kushteve ligjore të nevojshme për marrjen e licencës - lejes për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve – auto-taksi, duhet të plotësohen edhe këto kushte:
 - 1.1. Të jetë i/e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovë (ARBK) për këtë lloj transporti;
 - 1.2. Të jetë banor/e i/e Komunës së Ferizajt;
 - 1.3. Të dëshmojë se është pronar/e i/e veturës me librezë dhe/ose me marrëveshjen e nënshkruar mbi kredi (lizing);
 - 1.4. Të posedoj patent shofer të kategorisë “B” më të vjetër se (5) vite;
 - 1.5. Të jetë i/e pajisur me certifikatën që nuk është në hetime (jo më e vjetër se 6 muaj);
 - 1.6. Të jetë i/e pajisur me certifikatën e mjekut për shofer profesionist taksi;
 - 1.7. Të mos jetë në merdhënie pune ose shfrytëzues i pensionit të pleqërsisë;
 - 1.8. Të ketë certifikatën e automjetit të lëshuar nga inspektori i komunikacionit.

Licencë – Leje për operator taksi (kompani taksi).

Neni 8

1. Përveç kushteve ligjore të nevojshme për marrjen e licencës - lejes për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve – operatorë taksi, duhet të plotësohen dhe këto kushte:
 - 1.1. Të jetë i/e regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) për këtë lloj transporti;
 - 1.2. Të ketë selinë brenda territorit të Komunës së Ferizajt;
 - 1.3. Të mos ketë pengesa juridike në ushtrimin e veprimtarisë taksi (certifikata në emër të biznesit, pronarit të biznesit);

- 1.4. Të ketë flotën prej minimum 5 (pesë) automjete dhe jo më shumë se 20 automjete.
 - 1.5. Të dëshmojë se të gjitha automjetet janë të regjistruar në emër të kompanisë me librezë ose me marrëveshjen e nënshkruar mbi kredi (lizing);
 - 1.6. Të ketë hapësirë parkingu për automjetet në pronësi të tij/saj ose të kontraktuar si dhe numri i vendparkimeve të jetë i njëjtë me numrin e automjeteve për të cilat aplikon për licencë – leje;
 - 1.7. Të gjithë shoferët e punësuar në kompani duhet të posedojnë patent shofer të kategorisë “B” më të vjetër se (5) vite;
 - 1.8. Të gjithë shoferët e punësuar në kompani duhet të pajisen me certifikatën e mjekut për shofer profesionist taksi;
 - 1.9. Të ketë certifikatat e automjeteve në emër të kompanisë të lëshuar nga inspektori i komunikacionit;
2. Për çdo ndryshim në automjete dhe shofer taksi, operatori taksi është i obliguar që t'a njoftojë organin i cili ka lëshuar licencën - lejen.

Automjeti për transport taksi (taxi).

Neni 9

1. Përveç kushteve të përcaktuara me Ligj, automjeti taksi duhet t'i plotësojë edhe këto kushte:
 - 1.1 Automjeti duhet të ketë jo më shumë se pesë (4+1) ulëse dhe së paku katër (4) dyer;
 - 1.2 Timoni duhet të jetë në krahun e majtë;
 - 1.3 Të jetë i pajisur me taksimetër, në gjendje të rregullt teknike, i ekuilibruar (bazhdaruar) për çdo vit, i atestuar dhe vulosur sipas kushteve të përcaktuara për taksimetër dhe i vendosur në vend të dukshëm për udhëtarë;
 - 1.4 Të ketë aparatën kundër zjarrit të përforcuar në vend të përshtatshëm;
 - 1.5 Operatori – Kompania taksi duhet të ketë automjetet me ngjyrë të kaltërt të hapur, emri operatorit taksi i shënuar në automjet duhet të jetë i njëjtë si në librezë, Certificate te biznesit dhe në licencë – leje (për operatorët e rinjë vlen në momentin e miratimit të kësaj rregullore, kurse operatorëve ekzistues pas 6 muajsh duhet aplikohet ngjyra e veturave);
 - 1.6 Automjeti duhet të jetë teknikisht në rregull për transportin e udhëtarëve dhe kontrolli teknik të bëhet çdo 6 muaj (kontroll periodike);
 - 1.7 Shenjën e unifikuar "TAXI" të vendosur mbi automjet, e cila duhet të ketë ndriçim;
 - 1.8 Reklamat dhe shenjat e ndryshme (me leje nga Komuna) në automjet të mos jenë mbi sipërfaqen e xhamave, në pjesën e përparme dhe të prapme të automjetit si dhe xhamat të mos jenë të errësuar;
 - 1.9 Shenja e unifikuar "TAXI" si në pikën 1.9. të këtij neni, do të përmbajë informata sipas udhëzuesit, si p.sh. emblemën e Komunës së Ferizajt, mbishkrimin, numrin e licencës - lejes së automjetit.
2. Në rastet kur bëhet ndërrimi i automjetit për destinim taksi, operatori taksi apo auto taksi është i detyruar që ta kthejë certifikatën e automjetit te autoriteti kompetent, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

III . TAKSAT PËR LICENCIM-LEJE DHE CERTIFIKATË TË AUTOMJETIT TAKSI

Neni 10

1. Taksi individual (auto-taksi) pas plotësimit të kushteve të parapara sipas dispozitave të nenit 7 të kësaj rregulloreje, do të pajiset me licencë - leje në kohëzgjatje për 5 vjet, me mundësi vazhdimi.
2. Taksi individual (auto-taksi) sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të paguajë licencën - lejen në shumën prej 50 euro, të cilën taksë do ta paguajë në momentin e aplikimit për licencim – leje, e njëjta taksë aplikohet edhe për rastet e vazhdimit të licencës/lejes.
3. Taksi individual (auto-taksi) në pronësi të gjinisë femërore, të cilat pajisen me licencë – leje sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni, lirohen nga kjo taksë.

Neni 11

1. Taksi kompani (operatorë taksi), pas plotësimit të kushteve të parapara sipas dispozitave të nenit 8 të kësaj rregulloreje, do të pajiset me licencë - leje në kohëzgjatje për 5 vjet, me mundësi vazhdimi.
2. Taksi kompani (operatorë taksi), sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të paguajë licencën - lejen në shumën prej 500 Euro, të cilën shumë duhet ta paguajë në momentin e aplikimit për licencim – leje, e njëjta taksë aplikohet edhe për rastet e vazhdimit të licencës/lejes.

Neni 12

1. Taksi individual (auto-taksi) dhe operator taksi pas plotësimit të kushteve të parapara sipas dispozitave të nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, do të pajiset me certifikatë të automjetit në kohëzgjatje prej 5 vite.
 - 1.1.Taksi individual (auto-taksi) sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të paguajë shumën prej 10 euro, të cilën taksë duhet ta paguajë në momentin e aplikimit për marrjen e certifikatës.
 - 1.2.Të gjithë taksitë individual (auto-taksi) në pronësi të gjinisë femërore, lirohen nga kjo taksë.
 - 1.3.Taksi kompani (operatorë taksi), sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të paguajë shumën prej 20 euro, për secilën automjet, të cilën taksë duhet ta paguajë në momentin e aplikimit për marrjen e certifikatës.

IV. PUNËT ADMINISTRATIVE

Neni 13

1. Punët administrative për lejimin e ushtrimit të veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me taksi i kryen zyrtari i lartë për transport dhe trafik rrugor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë (DSHPE) Komuna Ferizajt.
2. Procedurat administrative për kryerjen e veprimtarisë së shërbimeve taksi i drejtohen Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë (DSHPE) duke i bashkëngjitur edhe dëshmitë për plotësimin e kushteve të parapara sipas ligjit dhe kësaj rregulloreje.

3. Pas shqyrtimit dhe miratimit të procedurave administrative sipas këtij neni, zyrtari kompetent nga DSHPE-ja e lëshon licencën-lejen për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve me automjete taksi (taksi individual dhe operator taksi).

Neni 14

1. Taksitë individ dhe taksitë kompani për çdo ndryshim që paraqitet në rastin e ndryshimit të gjendjes teknike apo të shënimeve të tjera që ekzistojnë në licencën-lejen e ushtrimit të veprimtarisë taksi, për automjetin me të cilin ai/ajo kryen këtë veprimtari (p.sh. ndërrimi i veturës, ndryshimi i adresës së pronarit/es etj.), duhet të zhvillohet procedurë e re administrative të DSHPE-së në afatin kohor prej pesëmbdhjetë (15) ditësh nga dita e paraqitjes së këtij ndryshimi.
2. Për taksitë kompani (operatorë transporti taksi), licenca-leja do të ndryshohet nga organi kompetent pranë DSHPE-së, nëse ndryshohet emërtimi i kompanisë, adresa, apo bëhet ndërrimi i pronarit/es.

V. VEND-PARKINGJET E AUTOMJETEVE TAKSI

Neni 15

1. Vend-parkingjet e automjeteve taksi janë sipërfaqe publike të destinuara për qëndrimin e taksistëve individualë (auto-taksi).
2. Vend-parkingje e automjeteve taksi individ shënohet me shenjat horizontale dhe vertikale të trafikut. Në shenjën vertikale shënohet "Parking taksi" dhe numri i vendeve, kurse me shenja horizontale shënohet mbishkrimi "TAXI" brenda një hapësire për parking.
3. Në vend-parkingje ndalohet të ketë më shumë automjete sesa që ka vende të shënuara me shenja horizontale dhe vertikale të trafikut.

Neni 16

1. Për mirëmbajtjen e vend-parkingjeve të automjeteve taksi, vendosjen dhe mirëmbajtjen e shenjave të trafikut, angazhohet operatori ekonomik i kontraktuar nga Komuna e Ferizajt.
2. Vend-parkingjet e automjeteve taksi si në nenin 15 të kësaj rregulloreje, numrin, mënyrën e shfrytëzimit, do të rregullohen nga zyrtari i lartë për transport dhe trafik rrugor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencë në bashkëpunim me NPL. "Ambienti".

Neni 17

1. Drejtuesi/ja i/e automjetit taksi është i/e obliguar të jetë pranë ose brenda automjetit të vetë gjatë gjithë kohës derisa qëndron në vend-parkingje të automjeteve taksi.
2. Drejtuesi/ja i/e automjetit taksi nuk guxon të ofrojë shërbime të transportit personalisht apo përmes ndërmjetësuesit/es dhe të fillojë transportin jashtë vend-parkingjeve të automjeteve taksi.
3. Drejtuesi/ja i/e automjetit taksi mund të marrë udhëtarë jashtë vend-parkingjeve të automjeteve taksi, në vendet ku nuk ndalohet parkimi dhe ndalja e automjeteve, por vetëm më kërkesën e udhëtarit.

4. Drejtuesi/ja i/e automjetit taksi nuk guxon të qëndrojë, e as të marrë udhëtarë në vend-parkingjet për transportin publik të udhëtarëve (vendndaljet e autobusëve, në stacionet e autobusëve).

Neni 18

1. Drejtuesi/ja i/e automjetit taksi obligohet të pranojë për transport secilin udhëtar në kufijtë e ulëseve që ka në dispozicion si dhe bagazhin e udhëtarit në kufijtë e madhësisë dhe të fuqisë bartëse të hapësirës për bagazh.
2. Drejtuesi/ja i/e automjetit taksi është i/e obliguar të sillet me kujdes dhe në mënyrë korrekte me udhëtarët.

Neni 19

1. Drejtuesi/ja i/e automjetit taksi është i/e obliguar që transportin ta fillojë:
 - 1.1. Nga vend-qëndrimi,
 - 1.2. Sipas thirrjes telefonike.

Neni 20

1. Transporti me automjet taksi fillon me hyrjen e udhëtarit në automjet.
2. Drejtuesi/ja i/e automjetit taksi obligohet që, me të hyrë udhëtarit në automjet, të aktivizojë taksimetrimin, i cili duhet të jetë në vend të dukshëm nga udhëtarit.
3. Drejtuesi/ja i/e automjetit taksi është i/e obliguar që gjatë udhëtimit të jetë i rregulluar në nivelin e duhur, duke respektuar kodin e veshjes.

VI. KOMPENSIMI PËR KRYERJEN E TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE

Neni 21

1. Kompensimi për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve, përcaktohet me çmimore të shërbimeve dhe paguhet në shumën që tregon taksimetri në vendin e arritjes së udhëtarit.
2. Në shumën e kompensimit për kryerjen e transportit taksi të udhëtarit, është llogaritur edhe transporti i bagazhit. Drejtuesi/s i/e automjetit taksi është i obliguar të japë faturën për shërbimin e kryer.
3. Propozimin e çmimores nga paragrafi 1 i këtij neni e prezanton operatori taksi edhe taksi individual (auto-taksi), vërtetimin e çmimores e bënë organi kompetent nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë. Çmimorja duhet të jetë e vendosur në vend të dukshëm brenda automjetit.

Neni 22

1. Me automjet taksi nuk mund të transportohen:

- 1.1. Personat në ndikim të alkoolit në ulëset e përparme të automjetit, në ndikim të drogës dhe personat e sëmurë me sëmundje ngjitëse;
- 1.2. Kufomat;
- 1.3. Kafshët e ngordhura;
- 1.4. Materiet e rrezikshme: eksploduese, radioaktive, helmuese, infektive, ato që ndizen lehtë dhe materie të tjera të cilat për shkak të vetive të veta mund të paraqesin rrezik për sigurinë dhe shëndetin e njerëzve, apo mund të shkaktojnë dëmtime të tjera, si dhe armët e ftohta dhe armët e zjarrit.

VII. NDËRPRERJA DHE REVOKIMI I LICENCËS - LEJES PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË TRANSPORTIT TAKSI TË UDHËTARËVE

Neni 23

Shfuqizimi i licencës/lejes së punës

1. Licenca / Leja e punës shfuqizohet:
 - 1.1. Me kërkesë për ç' regjistrim për kryerjen e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve;
 - 1.2. Me skadimin e afatit dhe në harmoni me nenet 7 dhe 8 të kësaj Rregulloreje.
 - 1.3. Nëse vdes titullari apo humb aftësinë për shofer.
 - 1.4. Kur humbet ndonjëra nga kushtet e parapara me Ligj dhe me këtë Rregullore për marrjen e lejes.
 - 1.5. Nëse shoferi taksi arrinë moshën e pleqërisë (pensionimit).

Neni 24

1. Taksi individual në rast të ndërprerjes së veprimtarisë, obligohet t'i kthejë licencën dhe certifikatën e automjetit për ushtrimin e kësaj veprimtarie drejtorisë kompetente.
2. Veprimtaria për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve ndërpritet me fshirjen nga regjistri i taksistëve aktiv, por mbetet në regjister elektronik të Komunës.

Neni 25

1. Licenca – Leja për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve humb vlerën kur:
 - 1.1. Operatori falimenton (nëse vërtetohet me vendim të autoriteteve kompetente);
 - 1.2. Mbaron afati i vlefshmërisë së saj;
 - 1.3. Kërkohet nga mbajtësi i saj;
2. Licenca - Leja për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve hiqet nga Drejtoria e cila e lëshon atë, kur:
 - 2.1. Vërtetohet se operatori ka humbur njërën nga kushtet e përcaktuara me nenet 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, me rastin e inspekimit;

- 2.2.Vërtetohet se mbajtësi i licencës shkel detyrimet e përcaktuara me këtë rregullore, me rastin e ri-inspektimit;
3. Licenca - Leja për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, i hiqet në mënyrë të përhershme atij operatori që është dënuar nga Gjykata kompetente për kryerjen e veprës penale për kontrabandim me narkotikë dhe trafikim të qenieve njerëzore.
- 3.1.Vendimi merret nga Drejtoria kompetente që ka lëshuar licencën - lejen, pas dëshmisë së provave dhe argumentimit sipas kësaj rregulloreje.
- 3.2.Inspeksioni i komunikacionit mund të iniciojë revokimin e licencës - lejes në rast se personi përgjegjës i personit juridik dhe personi fizik, bëjnë përsëritje disa herë të shkeljeve kundërvajtjeve.

VIII. MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI

Neni 26

1. Pronari/ja i/e automjetit taksi, i/e cili/a nuk ka licencë - leje për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve me shenjë unifikuese "TAXI", përjashtohet nga trafiku nga inspektori ose nga Policia sipas autorizimeve në bazë të ligjit dhe i përjashtohet automjeti në kohëzgjatje nga 48 orë deri në 5 (pesë) ditë. Kthimi i automjetit bëhet pas kalimit të kohës së përjashtimit dhe pagesës së gjobës mandatore dhe pagesës së shërbimeve të tjera për përjashtimin e automjetit (auto-tërheqësit).
2. Në rastet kur Komuna e Ferizajt nuk ka të autorizuar apo kontraktuar automjetet për tërheqje, Inspektori mund të marrë targat e automjetit taksi në kohëzgjatje prej 48 orë deri në pesë (5) ditë.
3. Vendimi për përjashtimin e automjetit taksi nga trafiku, i dorëzohet drejtuesit aty për aty. Pasojat dhe shpenzimet e krijuara për shkak të zbatimit të dispozitës nga paragrafi paraprak i këtij neni, në tërësi i bart drejtuesi i automjetit.
4. Hyrja dhe dalja e udhëtarëve nga automjeti taksi, nuk mund të bëhen në vend - ndaljet e autobusëve.
5. Kur drejtuesi/ja i/e automjetit taksi nuk kryen transportin taksi të udhëtarëve, përkatësisht kur përdor automjetin taksi për nevoja të veta, është i obliguar që të heqë shenjë "TAXI" nga automjeti.
6. Automjetet taksi, të regjistruara për transportin taksi të udhëtarëve në Komuna tjera, mund të sjellin udhëtarë në Komunën e Ferizajt dhe gjatë kthimit ata mund t'i kthejnë udhëtarët që i kanë sjellë, por nuk lejohen të marrin udhëtarë të tjerë.
7. Me automjetin taksi nuk mund të transportohet numër më i madh i udhëtarëve nga numri i ulëseve të regjistruara në automjet dhe nuk mund të vedosen ulëse shtesë më shumë se pesë (4+1) ulëse.
8. Të gjithë taksitë e paisur me licencë - leje janë të obliguar t'i paraqesë inspektorit tërë dokumentacionin e kërkuar dhe t'i krijojnë inspektorit të gjitha lehtësitë për ushtrimin e kompetencave sipas kësaj rregulloreje dhe legjislacionit në fuqi.
9. Transporti i udhëtarëve me taksi në linjë e rregullt është i ndaluar.

Inspektimi në Transportin Rrugor

Neni 27

Punët e inspektimit në transportin taksi të udhëtarëve brenda territorit të Komunës e bëjnë inspektorët, bazuar në këtë rregullore dhe legjislacione në fuqi si dhe Policia e Kosovës në kuadër të kompetencave të veta të përcaktuara me ligj.

Autorizimet e inspektorit të transportit rrugor

Neni 28

1. Gjatë ushtrimit të detyrës, inspektori është i autorizuar:

- 1.1. Të bëjë inspektimin dhe kontrollimin e operatorve taksi dhe taksi individual në komunikacionin rrugor të udhëtarëve lidhur me veprimtarinë e tyre, në pajtim me dispozitat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje;
- 1.2. Të bëjë inspektimin dhe kontrollimin e të gjitha automjeteve në transportin rrugor të udhëtarëve si dhe dokumentacionin dhe evidencat që i takojnë transportit rrugor;
- 1.3. Të përjashtojë automjetet taksi nga qarkullimi deri në dyzetetetë (48) orë, në qoftë se konstaton se operatori ose taksi individual është duke kryer transportin rrugor të udhëtarëve në kundërshtim me ligjin dhe këtë rregullore;
- 1.4. Në rastet kur inspektori shqipton masën e dënimit (gjobë) të njëjtit operator taksi apo taksi individual për herë të dytë, automjeti taksi do të përjashtohet nga qarkullimi në kohëzgjatje deri në pesë (5) ditë;
- 1.5. Me rastin e përjashtimit të automjetit auto - taksi, t'i marrë shenjën "TAXI" dhe lejen përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë;
- 1.6. Me rastin e përjashtimit të automjetit taksi nga qarkullimi, të marrë vendim që automjeti taksi i ndaluar të dërgohet në vend të caktuar me shpenzime të automjetit taksi dhe nëse është e domosdoshme mund të kërkojë ndihmën e policisë së Kosovës;
- 1.7. Të urdhërojë operatorin taksi dhe taksi individual për eliminimin e parregullsive në transportin taksi;
- 1.8. Të filloj iniciimin e procedurës pranë Gjykatës Kompetente, kur konstaton se transportuesi taksi ka bërë shkelje të dispozitave të ligjit apo të kësaj rregullore;
- 1.9. Të nxjerrë vendim për:
 - 1.9.1. Ndalimin e përkohshëm, sipas nënparagrafit 1.3. të këtij neni ;
 - 1.9.2. Përjashtimin e automjetit nga qarkullimi, sipas nënparagrafit 1.4. të këtij neni;
 - 1.9.3. Eliminimin e parregullsive, sipas nënparagrafit 1.5. të këtij neni;
- 1.10. Inspektorët, në mënyrë periodike bëjnë verifikimin e kushteve të licencës/lejes së operatorëve të transportit;
- 1.11. Inspektori mund të iniciojë procedurë për revokimin e licencës/lejes nëse operatori përsërit shkeljet kundërvajtëse;

IX. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Gjobat Neni 29

1. Operatori taksi, përkatësisht personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik, për kundërvajtje do të ndëshkohet me gjobë prej 100 euro, ndërsa personi juridik për kundërvajtje do të dënohet me gjobë prej 1,000 euro nga Inspektori i komunës:
 - 1.1.Nëse vepron në kundërshtim me nenin 4 të kësaj rregulloreje;
 - 1.2.Nëse vepron në kundërshtim me nenin 5 të kësaj rregulloreje;
 - 1.3.Nëse vepron në kundërshtim me nenin 6 të kësaj rregulloreje;
 - 1.4.Nëse vepron në kundërshtim me nenin 7 të kësaj rregulloreje;
 - 1.5.Nëse vepron në kundërshtim me nenin 8 të kësaj rregulloreje;
 - 1.6.Nëse vepron në kundërshtim me nenin 9 të kësaj rregulloreje.
 - 1.7.Nëse vepron në kundërshtim me nenin 10 të kësaj rregulloreje;
 - 1.8.Nëse vepron në kundërshtim me nenin 11 të kësaj rregulloreje;
 - 1.9.Nëse vepron në kundërshtim me nenin 12 të kësaj rregulloreje;
 - 1.10. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 14 të kësaj rregulloreje;
 - 1.11. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 17 të kësaj rregulloreje;
 - 1.12. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 18 të kësaj rregulloreje;
 - 1.13. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 19 të kësaj rregulloreje.
 - 1.14. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 20 të kësaj rregulloreje.
 - 1.15. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 21 të kësaj rregulloreje;
 - 1.16. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 22 të kësaj rregulloreje;
 - 1.17. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 23 të kësaj rregulloreje;
 - 1.18. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 24 të kësaj rregulloreje;
 - 1.19. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 25 të kësaj rregulloreje;
 - 1.20. Nëse vepron në kundërshtim me nenin 26 të kësaj rregulloreje;
2. Për kundërvajtje të njëjta që operatori, përkatësisht personi juridik apo fizik i përsërit, përveç dënimit me gjobë, do t'i shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës së ushtrimit të veprimtarisë së transportit në kohëzgjatje prej gjashtë (6) deri në dymbëdhjetë (12) muaj.

X. PROCEDURA E ANKESËS

Neni 30

1. Kundër Vendimit të lëshuar nga inspektori, mund të ushtrohet ankesë në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të aktit administrativ, komisionit komunal për ankesa të formuar me Vendim të kryetarit të komunës.
2. Kundër vendimit të komisionit komunal të ankesave të përcaktuar sipas paragrafit paraprak të këtij neni pala mund të parashtrojë Ankesë e cila i dërgohet Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës - Departamentit të Transportit, në afat prej 30 dite nga dita e njoftimit të Vendimit.

XI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 31

1. Procedura, sipas kërkesës për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve, që ka filluar e nuk ka përfunduar deri në hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, do të vazhdohet sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
2. Të gjithë operatorët të cilët janë të pajisur me licencë, në kohëzgjatje prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, obligohen t'i plotësojnë kriteret e specifikuara në të.

Neni 32

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve, 01.Nr.1413, dt. 28.02.2007 dhe të gjitha vendimet të cilat janë në kundërshtim me këtë rregullore.

Neni 33

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Kuvendi i Komunës së Ferizajt

Kryesuesi i Kuvendit

01 Nr. _____

Datë :

z. Xhavit ZARIQI